



DEKLARATË PËR PRAKTIKAT DHE POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT NË NDËRMARRJET PUBLIKE

Ne, të nënshkruarit më poshtë, me këtë Deklaratë deklarojmë përkushtimin tonë për përkujdesjen e kulturës së integritetit, transparencës dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve publike. Duke e njohur ndikimin e dëmshëm të korrupsionit ndaj ekonomisë, shoqërisë dhe reputacionit të shtetit tonë dhe të bashkësisë lokale, si dhe nevojën për mbrojtjen e interesit publik nëpërmjet veprimtarive që kryejmë, ne obligohemi se do t'i respektojmë standardet më të larta të sjelljes etike dhe do të luftojmë kundër korrupsionit në të gjitha format e tij. Kjo deklaratë përshkruan parimet dhe angazhimet tona të përbashkëta:

1. Udhëheqja etike e ndërmarrjes publike: Ne si udhëheqës të ndërmarrjes, punën tonë do ta bazojmë në integritetin, ndershmërinë, profesionalizmin, ekspertizën dhe të drejtën në veprimet dhe vendimet tona. Do të përmbahemi në përfshirjen e çdo forme të korrupsionit dhe në mënyrë aktive do të dekurajojmë sjelljen e tillë mes të punësuarve dhe palëve të prekura.

2. Zero tolerancë për korrupsionin: E vërtetojmë politikën tonë të tolerancës zero për korrupsionin. Ne nuk do të tolerojmë asnjë formë ryshfeti, mashtrimi, nepotizmi, konflikt të interesit apo praktika të tjera korruptive në ndërmarrjet publike që i udhëheqim. Obligohemi të ndërmarrim veprime vendimtare kundër kujtqo që është i përfshirë në aktivitete korruptive, duke përfshirë paraqitjen e rasteve të tilla në institucionet kompetente shtetërore të drejtësisë.

3. Harmonizimi me ligjet dhe aktet nënligjore : Obligohemi t'i respektojmë në përpikshmëri të gjitha ligjet që vlejnë, aktet nënligjore dhe standardet ndërkombëtare që lidhen me përpjekjet për luftë kundër korrupsionit. Do të kujdesemi që aktivitetet tona, prokurimet publike, procedurat e punësimit, ofrimin të shërbimeve dhe praktikave të punës t'i përmbahen standardeve më të larta etike dhe të udhëhiqen nga parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

4. Transparenca dhe llogaridhënia: Do të promovojmë transparencën në punën tonë duke publikuar në mënyrë publike informacione kyçe lidhur me aktivitetet tona, duke përfshirë raporte financiare, vendime për furnizime, aktet në procedurat e punësimit dhe akte dhe dokumente të tjera, me qëllim lehtësimin në realizimin e së drejtës për qasje të lirë te informatat me karakter publik.

5. Kodi i etikës: Do të zhvillojmë dhe zbatojmë kode gjithëpërfshirëse etike që do të përmbajnë udhëzime të qarta për të punësuarit dhe të anëtarëve të organeve të ndërmarrjes. Ky kod ka të bëjë me rreziqet e korrupsionit, konflikt të interesit dhe sjellje adekuate në të gjitha aspektet e punës sonë. Do të ofrojmë programe të rregullta trajnimi për promovimin e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e kodit të etikës midis të gjitha palëve të prekura.

6. Mbrojtja e denoncuesve: Ne jemi të përkushtuar të krijojmë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për denoncuesit që të denoncojnë korrupsionin pa frikë nga pasojat (hakmarrja). Do të zbatojmë mekanizma efektivë për pranimin dhe veprimin ndaj denoncuesve të denoncimeve, duke siguruar që të ndërmerren



veprimet e duhura kundër personave të përfshirë në praktika korruptive, sjellje të tjera të paligjshme dhe joetike dhe mbrojtjen e identitetit të denoncuesve.

7. Revizioni i brendshëm (kontrolli) dhe menaxhimi i rrezikut: Ne do të forcojmë kapacitetet e revizionit të brendshëm dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut që t'i parandalojmë, zbulojmë dhe zbusim rreziqet e korrupsionit. Do të kryejmë revizione të rregullta dhe vlerësime të rrezikut për të identifikuar dobësitë dhe t'i zbatojmë masat e nevojshme për mbrojtjen nga praktikat korruptive.

8. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i praktikave më të mira: Ne do të angazhohemi aktivisht me aktorët përkatës, duke përfshirë institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, mediumet, sektorin privat dhe organizmat ndërkombëtare, për të shkëmbyer praktikat, përvojat dhe njohuritë më të mira në luftën kundër korrupsionit.

9. Monitorimi dhe raportimi: Obligohemi që të krijojmë mekanizma të fuqishëm të mbikëqyrjes dhe raportimit që të përcjellim progresin tonë në zbatimin e masave kundër korrupsionit. Në mënyrë të rregullt do t'i vlerësojmë arritjet tona, përparësitë dhe dobësitë, do t'i identifikojmë fushat për përmirësim dhe do t'i bëjmë publike këto raporte për të treguar përkushtimin tonë ndaj llogaridhënies dhe transparencës.

10. Përmirësimi i vazhdueshëm: Ne pranojmë se lufta kundër korrupsionit është një përpjekje e vazhdueshme që kërkon vigjilencë dhe përmirësim të vazhdueshëm. Rregullisht do t'i rishikojmë dhe përditësojmë planet, programet, strategjitë dhe iniciativat tona kundër korrupsionit në bazë të trendeve të reja, mësimet e nxjerra dhe natyrën konstante të ndryshueshme të rreziqeve nga korrupsioni.

Me nënshkrimin e kësaj Deklarate, e vërtetojmë angazhimin tonë të palëkundur për respektimin e standardeve më të larta etike, parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në ndërmarrjet publike.

[Nënshkrimi] [Emri] [Pozicioni] [Data]